



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 5

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E mërkurë, 24 janar 2018**

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 32, datë 19.1.2018	Për përcaktimin e funksioneve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të strukturave të shërbimit të jashtëm në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian..... 99
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 23, datë 8.1.2018	Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në sh.a. Porti Detar Shëngjin” ..... 99
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 24, datë 8.1.2018	Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturës të sigurisë portuale të Autoritetit Portual Durrës”..... 100
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 25, datë 8.1.2018	Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në Terminalin Vlora-1 (PIA)”..... 100
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 26, datë 8.1.2018	Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në Portin Detar Vlorë sh.a.”..... 101
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 27, datë 8.1.2018	Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në sh.a. Porti Detar Sarandë”..... 101
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 28, datë 8.1.2018	Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturës së sigurisë portuale të Terminalit të Hidrokarbureve Romano Port sh.a. Durrës”..... 102
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 47, datë 11.1.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar”..... 102

Udhëzim i ministrit të Kulturës nr. 24, datë 12.1.2018	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 5166, datë 20.10.2016, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.....	103
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 5, datë 15.1.2018	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet në Qarkun Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	104
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 6, datë 15.1.2018	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Berat, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	106
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 989, datë 19.1.2018	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	108
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Artan Sherbet Spanjoli.....	108
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Fatmir Bruzja.....	108

**VENDIM**

Nr. 32, datë 19.1.2018

**PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE  
TË MINISTRISË PËR EVROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME DHE  
TË STRUKTURAVE TË SHËRBIMIT  
TË JASHTËM NË PROCESIN  
E INTEGRIMIT TË REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN  
EVROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare, ratifikuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të neneve 6, 9, 13 e 14, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, brenda fushës së përgjegjësive të saj shtetërore:

a) ndjek, orienton dhe bashkërendon veprimtarinë e rrjetit të njësisë të integrimit evropian në ministritë e linjës;

b) merr masat e nevojshme për të siguruar kapacitetet e duhura të shërbimit të jashtëm, në veçanti forcimin e misioneve diplomatike në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, për të siguruar mbështetjen e plotë të procesit të integrimit evropian;

c) harton platformën e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian;

ç) merr masat e nevojshme për sigurimin e ekspertizës së nevojshme në mbështetje të komunikimit të procesit të reformave në Shqipëri, në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, në përputhje me normat përkatëse në fuqi për punën me informacionin e klasifikuar.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ministritë e linjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Edi Rama**

**URDHËR**

Nr. 23, datë 8.1.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES  
“PËR ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE  
TË SIGURISË PORTUALE NË SHA PORTI  
DETAR SHËNGJIN”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 401, germa “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9213, datë 1.4.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare, “Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947””, dhe të nenit 5, pika “b”, të ligjit nr. 168/2013, datë 31.10.2013, “Për sigurinë në anije dhe në porte”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në sh.a. Porti Detar Shëngjin”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet sh.a. Porti Detar Shëngjin për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale për monitorimin e zbatimit të këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 10, datë 13.3.2007, “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në sh.a. Porti Detar Shëngjin”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
Damian Gjiknuri**



## URDHËR

Nr. 24, datë 8.1.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES  
“PËR ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS  
SË SIGURISË PORTUALE TË  
AUTORITETIT PORTUAL DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 401, germa “b”; të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9213, datë 1.4.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare, “Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947””, dhe të nenit 5, pika “b”, të ligjit nr. 168/2013, datë 31.10.2013, “Për sigurinë në anije dhe në porte”,

## URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturës së sigurisë portuale të Autoritetit Portual Durrës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Autoritetit Portual Durrës për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale për monitorimin e zbatimit të këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 18, datë 17.10.2011, “Për organizimin dhe funksionimin e strukturës së sigurisë portuale të Autoritetit Portual Durrës”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
**Damian Gjikhuri**

## URDHËR

Nr. 25, datë 8.1.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES  
“PËR ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE TË  
SIGURISË PORTUALE NË TERMINALIN  
VLORA-1 (PIA)”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 401, germa “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9213, datë 1.4.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare, “Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947””, dhe të nenit 5, pika “b”, të ligjit nr. 168/2013, datë 31.10.2013, “Për sigurinë në anije dhe në porte”,

## URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në Terminalin Vlora-1 (PIA)”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Terminali Vlora-1 (PIA) për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale për monitorimin e zbatimit të këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 2, datë 28.2.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në Terminalin Vlora-1 (PIA)”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
**Damian Gjikhuri**



## URDHËR

Nr. 26, datë 8.1.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES  
“PËR ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE TË  
SIGURISË PORTUALE NË PORTIN  
DETAR VLORË SHA”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 401, germa “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9213, datë 1.4.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare, “Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947””, dhe nenit 5, pika “b”, të ligjit nr. 168/2013, datë 31.10.2013, “Për sigurinë në anije dhe në porte”,

## URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në Portin Detar Vlorë sh.a.”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Porti Detar Vlorë sh.a. për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale për monitorimin e zbatimit të këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 47, datë 4.1.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në Portin Detar Vlorë sh.a.”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE  
ENERGJISË  
**Damian Gjikhuri**

## URDHËR

Nr. 27, datë 8.1.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES  
“PËR ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE TË  
SIGURISË PORTUALE NË SHA PORTI  
DETAR SARANDË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 401, germa “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9213, datë 1.4.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare, “Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947””, dhe të nenit 5, pika “b”, të ligjit nr. 168/2013, datë 31.10.2013, “Për sigurinë në anije dhe në porte”,

## URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në sh.a. Porti Detar Sarandë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet sh.a. Porti Detar Sarandë për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale për monitorimin e zbatimit të këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 3, datë 13.3.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë portuale në sh.a. Porti Detar Sarandë”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
**Damian Gjikhuri**

**URDHËR**

Nr. 28, datë 8.1.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES  
“PËR ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS SË  
SIGURISË PORTUALE TË TERMINALIT  
TË HIDROKARBUREVE ROMANO PORT  
SHA DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 401, germa “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9213, datë 1.4.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare, “Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947””, dhe të nenit 5, pika “b”, të ligjit nr. 168/2013, datë 31.10.2013, “Për sigurinë në anije dhe në porte”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturës së sigurisë portuale të Terminalit të Hidrokarbureve Romano Port sh.a. Durrës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Terminali i Hidrokarbureve Romano Port sh.a. Durrës për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale për monitorimin e zbatimit të këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 9, datë 24.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e strukturës së sigurisë portuale të Terminalit të Hidrokarbureve Romano Port sh.a. Durrës”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE  
ENERGJISË  
Damian Gjikhuri**

**UDHËZIM**

Nr. 47, datë 11.1.2018

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME  
NË UDHËZIMIN NR. 2365, DATË  
26.11.2008, “MBI ZBATIMIN E VENDIMIT  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 277,  
DATË 18.6.1997, “PËR PËRFITIMET  
NGA STATUSI I TË VERBRIT”,  
TË NDRYSHUAR”**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar dhe pikës 16, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Kudo në udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008, bëhen këto ndryshime:

Shprehjet “kurse kualifikimi” zëvendësohen me “kurse të formimit profesional”; “arsim i lartë apo studime pasuniversitare” zëvendësohen me “arsim i lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë”; “ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” zëvendësohet me “ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.

2. Pika 1 e udhëzimit riformulohet me këtë përmbajtje:

“1. Personat që kërkojnë të komisionohen/rikomisionohen për përfitime nga ligji nr. 8089, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, ndjekin sistemin shëndetësor të referimit.”

3. Pika 2 e udhëzimit riformulohet me këtë përmbajtje:

“2. Dokumentacioni që vlerësohet për përfitime nga ligji nr. 8089, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, përfshin fletën e drejtimit për në KMPV, të lëshuar nga komisioni mjekoligjor (KML), i specializuar pranë vendbanimit të individit.

Në përbërje të KML-së duhet të ketë minimalisht dy mjekë okulistë, me përjashtim të rasteve kur ka mungesë të këtij specialiteti, në përbërje të KML-së merr pjesë një mjek okulist.

Dokumentacioni i individit që rivlerësohet, përfshin epikrizën përcjellëse për në KMPV, të lëshuar nga mjeku okulist pranë vendbanimit të tij.



Dokumentacioni për vlerësim/rivlerësim së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit dërgohet brenda pesë ditëve nga institucioni shëndetësor, pranë njësisë administrative ku individi ka vendbanimin.”.

4. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1, 2/2 dhe 2/3, me këtë përmbajtje:

“2/1. Administratori shoqëror, me marrjen e dokumentacionit nga institucioni shëndetësor e dërgon atë brenda 24 orëve, me procesverbal, pranë mjekut të Shërbimit Social Shtetëror. Mjeku verifikon nëse dosjet e paraqitura janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës dhe, më pas, i përcjell ato në KMPV.

2/2. Në rastet e rivlerësimit, administratori shoqëror njofton dy muaj para përfundimit të afatit të vlerësimit, individin për t’u pajisur me epikrizë.

2/3. Rivlerësimi i dosjes në KMPV bëhet në varësi të gjendjes shëndetësore dhe gjithmonë dy muaj para përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e fundit.

Në rastet kur dokumentacioni nuk paraqitet në KMPV, në datën e rivlerësimit, ruhet e drejta për rishqyrtim gjatë periudhës tremujore në vazhdim.”.

5. Në fund të pikës 3 të udhëzimit shtohet:

“Kujdestari i të verbrit përcaktohet në deklaratën noteriale e cila përmban të dhëna lidhur me vendbanimin e kujdestarit dhe kopje të dokumentit të identifikimit të kujdestarit. Ky dokumentacion administrohet nga administratori shoqëror i njësisë administrative ku ka vendbanimin individ.”.

6. Pika 5 e udhëzimit riformulohet me këtë përmbajtje:

“Pagesat e përfituara për shkak të verbërisë, të përcaktuara në vendimin nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave dhe të gjitha përfitimet e tjera apo kompensimet që i verbri përfiton sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, merren të plota nga përfituesit. Bashkia merr masa që këto pagesa të mos tarifohen/komisionohen.”.

7. Në pikën 7 të udhëzimit, togfjalëshi “pra në masën 17 400 lekë në muaj”, shfuqizohet.

8. Në pikën 8 të udhëzimit, togfjalëshi “në masën 26 100 lekë në muaj”, shfuqizohet.

9. Pika 16 e udhëzimit riformulohet me këtë përmbajtje:

“16. Drejtoria e Komisionimit të Aftësisë së Kufizuar në Shërbimin Social Shtetëror, në përfundim të vlerësimit/rivlerësimit të verbërisë,

hedh brenda 30 ditëve nga data e vlerësimit/rivlerësimit në arkivin elektronik, dokumentacionin që përmban dosja e përfituesit.

Dosja e përfituesit dërgohet zyrtarisht pranë njësisë administrative së bashku me vërtetimin për vendimin, vendimin e KMPV-së dhe librezën e verbërisë të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.

Një kopje e vendimit të KMPV-së ruhet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.”.

10. Në pikën 13 të udhëzimit, togfjalëshi “pra në masën 13 000 lekë në muaj”, shfuqizohet.

11. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, institucionet shëndetësore dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
**Ogerta Manastirliu**

## UDHËZIM

Nr. 24, datë 12.1.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5166, DATË 20.10.2016, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË TJERA SHITESË NË SQARIM TË KRITEREVE TË PARASHIKUARA NË NENIN 133, SI DHE PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PROCEDURËS SË MARRJES SË LICENCËS OSE RIPËRTËRITJEN E SAJ, NË BAZË TË NENIT 134, TË LIGJIT NR. 35/2016, DATË 31.3.2016, “PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME TO”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 158, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; si dhe pikës 3, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,



## UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5166, datë 20.10.2016, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

“1. Germa “a” dhe “b”, e pikës 1, të kreut II, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS  
Mirela Kumbaro (Furxhi)

**VENDIM**  
Nr. 5, datë 15.1.2018

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË  
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË  
SHQIPËRISË KANDIDATIT TË LISTËS  
SHUMEMËRORE TË PARTISË  
DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET NË  
QARKUN ELBASAN, PËR PLOTËSIMIN E  
VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA  
KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 15.1.2018, me pjesëmarrjen e:

Klement	Zguri	kryetar
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet në Qarkun Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes së mandatit të deputetit të z. Aqif Rakipi.

Kërkues: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Baza ligjore: Neni 23, pika 1, germa “a”; neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit 138/2015, “Për

garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

## VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 57/1 prot., datë 10.1.2018, drejtuar KQZ-së, Sekretari Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancës për shkak të pavlefshmërisë dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të z. Aqif Rakipi, deputet i zonës zgjedhore Qarku Elbasan.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të së njëjtës parti politike, në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën shumëmemërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, për zonën zgjedhore Qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017, ka fituar 2 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet, Qarku Elbasan, është si më poshtë: me numër rendor 1 (një), z. Aqif Kahraman Rakipi; dhe 2 (dy) z. Bujar Shahin Muça.

KQZ-ja, me vendimin nr. 573, datë 6.12.2017, “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Qarku Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”, vendosi dhënien e mandatit kandidatit të radhës me numër rendor 03, në listën shumëmemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Qarku Elbasan, znj. Elena Josif Xhina, pas dorëheqjes së z. Bujar Muça.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Qarku Elbasan, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do





të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, me kandidatin e radhës. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, fjalia e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës shumëmemërore, të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet në zonën zgjedhore Qarku Elbasan.

KQZ-ja, me vendimin nr. 287, datë 5.5.2017, "Për miratimin e listave shumëmemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.6.2017", ka miratuar listën shumëmemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, për 12 zonat zgjedhore.

Sipas listës shumëmemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Qarku Elbasan, kandidati i radhës është kandidati me numër rendor 04 (katër), z. Dritan Abedin Bici.

Z. Dritan Abedin Bici, me cilësinë e kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, ka depozituar formularin e vetëdeklarimit në KQZ, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreu V, pika 2, germa "b", dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", KQZ-ja, me shkresat nr. 34 prot., datë 9.1.2018, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe me shkresën nr. 2448 prot., datë 1.5.2017, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, për funksionarin publik që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në KQZ.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Dritan Bici, në cilësinë e kandidatit për deputet të subjektit politik Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Qarku Elbasan, rezulton se është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me një vendim gjyqësor të formës së prerë, nr. 382 datë 19.9.2013, për veprën penale "Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik", parashikuar nga neni 242

i Kodit Penal, dhe ndaj tij është caktuar masë dënimi: "Punë me interes publik", parashikuar nga neni 63/1 i KP-së.

Sipas shkresës nr. 3541/1, datë 6.7.2017, informacionit të ardhur nga Zyra e Gjendjes Civile, rezulton se z. Dritan Bici nuk ka kryer ndryshime në gjenealitetet e tij.

Sipas shkresës nr. 63/1, datë 10.1.2018, të ardhur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, në KQZ rezulton se z. Dritan Bici, në bazë të vendimit nr. 382, datë 19.9.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan e ka deklaruar fajtor për veprën penale: "Mosbindje ndaj urdhrat të policisë së rendit publik", parashikuar nga neni 242 i KP-së dhe neni 406 i KPRP-së, dënohet me 1 (një) muaj burgim. Në zbatim të nenit 63 të KP-së zëvendësohet dënimi me punë në interes publik prej 80 orësh.

Në bazë të nenit 69 të KP-së është rehabilituar.

Referuar nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike":

Ndalimi për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik

1. Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak dhe, në çdo rast, nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për: a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88, paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278, paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 287, i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal; b) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/ç apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në kreun X, "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve", të Kodit Penal;



c) kryerjen e një krimi, që nuk përfshihet në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, për të cilin janë dënuar me jo më pak se 2 vjet burgim; ç) për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.

Referuar nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, të kandidatit të radhës të subjektit politik, Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, z. Dritan Abedin Bici, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas këtij ligji.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidadit të radhës, i renditur me numër rendor 04 (katër) në listën shumemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, z. Dritan Bici.

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

#### VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Qarku Elbasan, z. Dritan Abedin Bici.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**Klement Zguri**

#### VENDIM

**Nr. 6, datë 15.1.2018**

### **PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM, QARKU BERAT, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 15.1.2018, me pjesëmarrjen e:

Klement	Zguri	kryetar
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Berat, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes së mandatit të deputetit z. Gledjon Rehovica.

Kërkues: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Baza ligjore: Neni 23, pika 1, germa “a”; neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

#### VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 57/1 prot., datë 10.1.2018, drejtuar KQZ-së, Sekretari Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancës për shkak të pavlefshmërisë dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të z. Gledjon Rehovica, deputet i zonës zgjedhore Qarku Berat.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit



kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt, për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore Qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017, ka fituar 2 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për Qarkun Berat, është si më poshtë: me numër rendor 1 (një) z. Nasip Qani Naço; dhe 2 (dy) z. Gledjon Tomorr Rehovica.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Berat, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, me kandidatin e radhës. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, fjalia e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në zonën zgjedhore Qarku Berat.

KQZ-ja, me vendimin nr. 288, datë 5.5.2017, "Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.6.2017", ka miratuar listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për 12 zonat zgjedhore.

Referuar nenit 11, të ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant sipas Kodit Zgjedhor.

Në këto kushte, kandidati vijues i listës shumemërore të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Berat, të cilit i kalon

mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 03, znj. Silva Maksim Caka.

Znj. Silva Maksim Caka ka depozituar formularin e vetëdeklarimit në KQZ, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksione publike.

Në zbatim të nenit 11, ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", KQZ-ja bëri publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit dhe verifikimin e të dhënave në këtë formular.

KQZ-ja, me shkresën nr. 2452/6 prot., datë 3.6.2016, kërkoi informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 34 prot., datë 9.1.2018, kërkoi informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Berat, znj. Silva Maksim Caka.

Sipas informacionit të ardhur nga zyra e gjendjes gjyqësore, me shkresën nr. 63/1 prot., datë 10.1.2018, në KQZ, rezulton se znj. Silva Maksim Caka, kandidate për deputete në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Berat, është e padënuar nga gjykatat shqiptare.

Sipas informacionit të ardhur nga zyra e gjendjes civile, me shkresën 3240/3 prot., datë 12.7.2016, rezulton se znj. Silva Maksim Caka nuk ka kryer ndryshime në gjenealitetet e saj.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të znj. Silva Maksim Caka rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës, i renditur me numër rendor 03 (tre), në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në zonën zgjedhore Qarku Berat, znj. Silva Maksim Caka.

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a" dhe nenin 164, të



ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

**VENDOSI:**

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Berat, znj. Silva Maksim Caka.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**Klement Zguri**

**NJOFTIM**

**Nr. 989, datë 19.1.2018**

**MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË  
MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE**

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Indisë, mbi përjashtimin nga kërkesa për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe zyrtare/shërbimi, nënshkruar më 27.11.2015, hyn në fuqi më 20.1.2018.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM  
I MINISTRISË PËR EVROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME**  
**Gazmend Barbullushi**

**KËRKESË**

Shtetasi Sokol Spanjoli, i datëlindjes 7.5.1966, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të zhdukur të shtetasit Artan Sherbet Spanjoli, i datëlindjes 25.8.1969.

**KËRKUES**  
**Sokol Spanjoli**

**KËRKESË**

Shtetasja Eda Bruzja, e datëlindjes 25.11.1958, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Fatmir Bruzja, i datëlindjes 31.8.1968.

**KËRKUES**  
**Eda Bruzja**







	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë